

# ZBATIMI I TRAKTATEVE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË PËRFSHIRA NË KUSHTETUTËN E KOSOVËS

Material për diskutim

ECMI Kosova

Nëntor, 2018



European  
Union  
Kosovo

## Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

## OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

**ECMI Kosova** ([www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org))

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

**Rruga "Nëna Terezë" Nr. 20, Apt. 5,  
10000 Prishtinë—Kosovë,  
Tel. +383 (0) 38 224 473**

**Rruga "Kralja Petra" 183a  
38220 Mitrovicë e Veriut—Kosovë,**

## Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, të cilat punojnë së bashku me 19 OJQ, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Fokus i specifik i projektit janë këto grupe: komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit;

## Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosova dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## E drejta e autorit©

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), tetor 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



# ZBATIMI I TRAKTATEVE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TË PËRFSHIRA NË KUSHTETUTËN E KOSOVËS

Material për diskutim



European  
Union  
Kosovo



## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>KAPITULLI 1</b> .....	<b>8</b>
Marrëdhëniet e Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.....	8
TNDNj-të e përmendura në Kushtetutë.....	8
<b>KAPITULLI 2</b> .....	<b>12</b>
Vështirësitë e zbatimit të drejtpërdrejtë.....	12
Zbatimi i TNDNj-ve në Kosovë.....	14
Mungesa e ekspertizës dhe njohurive të posaçme mbi të drejtën ndërkombëtare.....	15
Mangësitë e kapaciteteve njerëzore dhe transparencës.....	17
<b>VËREJTJET PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>20</b>
<b>REFERENCAT</b> .....	<b>22</b>

## **LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE**

<b>AeD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>KEDNG</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
<b>KiE</b>	Këshilli i Europës
<b>PTV</b>	Program i Trajnimit të Vazhdueshëm
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>ECMI Kosova</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë
<b>KEGjRM</b>	Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>ERAC</b>	Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë
<b>BE</b>	Bashkimi European
<b>KKMPK</b>	Konventa Kornizë e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
<b>KDNj</b>	Këshilli për të drejtat e njeriut
<b>KNDCP</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
<b>KEGjFDR</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
<b>TNDNj</b>	Traktatet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut
<b>KFOR</b>	Forca e Kosovës
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>OJQ</b>	Organizata jo-qeveritare
<b>MPN</b>	Mekanizmi Parandalues Nacional kundër Torturës
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>IPVQ</b>	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
<b>DUDNj</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
<b>KB</b>	Kombet e Bashkuara
<b>KKTTNMÇP</b>	Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar
<b>KDF</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNMIK</b>	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Edhe gjatë periudhës së administrimit ndërkombëtar 1999-2008 edhe pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në konsolidimin e të drejtave të njeriut. Në veçanti, në planin ndërkombëtar, Kosova ka marrë lëvdata për kornizën e saj të gjerë ligjore në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara dhe komuniteteve të tjera pakicë. Megjithatë, si në shumë fusha të legjislacionit kosovar, ende ekziston një mospërputhje e madhe midis legjislacionit dhe zbatimit të tij në praktikë. Megjithëse ligjet mbi të drejtat e njeriut të përmendura në Kushtetutën e Kosovës janë hartuar shumë mirë, shumica e tyre ende nuk zbatohen siç duhet. Disa shembuj përfshijnë Nenin 59 për të Drejtat e Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë dhe, në mënyrë kritike për këtë dokument, Nenin 22 që parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të Marrëveshjeve Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Veçanërisht Ligji kundër diskriminimit dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve perceptohen si ligje të avancuara, por—edhe pse këto ligje duket të jenë efektive nga një perspektivë e jashtme, mos-efikasiteti i mekanizmave të zbatimit i bën ato të paarritshme apo të parealizuara në mbrojtje të interesave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.<sup>1</sup>

Zbatimi joefektiv i ligjeve në Kosovë mund të vërehet veçanërisht kur i referohemi legjislacionit me bazë në të drejtën ndërkombëtare. Marrë parasysh që Kosova nuk shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian (BE), ajo nuk është shtet-palë apo palë nënshkruese e të gjitha ligjeve dhe konventave ndërkombëtare. Megjithatë, nenet 22, 53 dhe 58 të Kushtetutës së Kosovës përfshijnë apo përmendin tetë Traktate Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (TNDNJ) të cilat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë dhe, në rast konflikti, madje kanë prioritet ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Ky raport do të analizojë zbatimin e këtyre traktateve brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Intervistat me ekspertët ligjorë, të nivelit të lartë, u zhvilluan në mënyrë që të kërkonin një përgjigje për këtë çështje kërkimore. Raporti do të shpjegojë së pari marrëdhënien juridike të Kosovës me të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Më pas, do të diskutohen vështirësitë e zbatimit të drejtpërdrejtë të këtyre ligjeve; raporti, gjithashtu, do të shqyrtojë edhe faktorë të tjerë, që në mënyrë të veçantë, pengojnë zbatimin e këtyre traktateve në Kosovë. Raporti më pas do të japë disa vërejtje përfundimtare dhe konkluzione duke u bazuar në analizën e ofruar.

Qëllimi parësor i këtij raporti është të ofrojë një diskutim mbi çështjet që lidhen me zbatimin e Traktateve Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut të përmendura në kushtetutën e Kosovës, me qëllim të nxitjes së debatit të mëtejshëm. Pa dyshim, përkushtimi kushtetues i Kosovës ndaj të drejtave të njeriut është i lavdërueshëm; megjithatë, si në shumë fusha të tjera të legjislacionit të Kosovës, përmbajtja e ligjeve nuk përputhet me zbatimin faktik të tyre. Në një periudhë afatshkurtër, duhet të inkurajohet një diskutim i përmirësuar dhe konsideratë e shtuar se si të zbatohen më mirë traktatet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Në planin afatgjatë, shpresohet se përparimi i vazhdueshëm i Kosovës drejt shtetësisë së padiskutueshme dhe anëtarësisimit të saj në Këshillin e Europës dhe në Kombet e Bashkuara do të lejojë që Kosova të bëhet palë nënshkruese e këtyre traktateve, duke çuar në zbatim plotësisht efektiv të të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare.

<sup>1</sup> Adem Beha, 'Të Drejtat e Pakicave: Një mundësi për përshtatjen e marrëdhënieve etnike në Kosovë?', Gazeta mbi Etno-politikën dhe çështjet e pakicave në Europë 13 (2014) 98.

### Marrëdhëniet e Kosovës me të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut

Përkundër angazhimit të qartë të Kosovës për të drejtat e njeriut, mbrojtja e të drejtave të individëve në të gjithë vendin mbetet e pamjaftueshme: Raporti Botëror edicioni i vitit 2018: Seksion mbi Kosovën ... i Human Rights Watch—thotë se Kosova ka bërë progres të ngadalshëm në të drejtat e njeriut në vitin 2017. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në sistemin qeverisës dhe kushtetutë ka qenë një nga qëllimet kryesore të pranisë së bashkësisë ndërkombëtare. Kushtetuta e Kosovës, e zhvilluar në përputhje me Planin e Ahtisaarit, ofron mbrojtje të gjerë për të drejtat e njeriut, duke përfshirë të drejtat e pakicave. Një nga mënyrat kryesore për të arritur këtë qëllim është referimi në instrumentet ekzistuese ligjore ndërkombëtare. Nga njëra anë, kjo mund të shihet si një trashëgimi e periudhës së administrimit ndërkombëtar 1999-2008, kur Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) i dha një pozicion të privilegjuar marrëveshjeve dhe ligjeve ndërkombëtare dhe “kultivoi një kulturë juridike të zbatimit të normave dhe legjislacionit ndërkombëtar në Kosovë”.<sup>2</sup> Nga ana tjetër, duke përfshirë referencën dhe/apo të përmendurit e traktateve ndërkombëtare në kushtetutë, ishte një mënyrë efektive për t'i bërë dokumentet ligjorisht të detyrueshme në Kosovë pavarësisht faktit se me njohjen e kufizuar ndërkombëtare të shtetësisë, Kosova nuk është gjithmonë në gjendje të hyjë, në mënyrë formale, në marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe.<sup>3</sup>

Integrimi i instrumenteve ndërkombëtare në kushtetutën e Kosovës ka qenë një hap i rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat e njeriut në nivel vendi.<sup>4</sup> Këto instrumente janë institucionalizuar drejtpërdrejt brenda kushtetutës. Nenet 22, 53 dhe 58 përfshijnë një numër marrëveshjesh dhe instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, me theks të veçantë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDLNjP), Konventën Ndërkombëtare për Çështjet Civile dhe Politike (KNÇCP), Konventën Kornizë të KiE-së për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM) dhe Konventat e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEGjFDR), dhe për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGjFDNG), Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar (KKTNTMÇP). Sidoqoftë, duke marrë parasysh që Kosova nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, këto instrumente ndërkombëtare nuk janë gjithmonë të zbatueshme dhe qytetarët nuk mund të parashtrajnë ankesa në organet përkatëse.<sup>5</sup> Seksioni në vijim do të ofrojë një skicë të traktateve të përmendura në kushtetutë dhe përdorimin e tyre në Kosovë.

### TNDNJ-të e përmendura në Kushtetutë

#### Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR)

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (UDHR), e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1948, përbëhet nga tridhjetë nene që numërojnë të drejtat që janë thelbësore për

<sup>2</sup> V. Morina, Korenica, F. dhe Doli, D., “Marrëdhënia ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës kombëtare në rastin e Kosovës: Një perspektivë kushtetuese”, Gazeta Ndërkombëtare e së Drejtës Kushtetuese 9 (2011) faqet 274-296.

<sup>3</sup> Ibidem.

<sup>4</sup> Paul de Hert & Fisnik Korenica, “Kushtetuta e Re e Kosovës dhe Marrëdhënia e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Kushtetutshmëria “Pa” Ratifikim në Shoqëritë Pas Konfliktit”, Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht 76 (2016) faqet 144-145.

<sup>5</sup> Ibidem.



të gjithë njerëzit. Në preambulën e saj, Deklarata përshkruan veten si “një standard i përbashkët arritjesh për të gjithë popujt dhe të gjitha kombet”, drejt të cilave “do të përpiqet dhe angazhohet çdo individë dhe çdo pjesë e shoqërisë.” Megjithatë, Deklarata nuk ka status traktati dhe nuk ka nuk është menduar kurrë këtë efekt të detyrueshëm ligjor mbi shtetet.<sup>6</sup> Por, qëllimi i DUDNJ-së ishte të përcaktojë termat “liritë themelore” dhe “të drejtat e njeriut” që përdoren në Kartën e OKB-së, të cilat në vetvete janë ligjërish të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.<sup>7</sup> Me fjalë të tjera, Deklarata ishte menduar si një deklaratë politike aspiruese dhe frymëzuese. Deklarata e përjashton zbatimin e drejtpërdrejtë, sepse përcakton që ajo duhet të realizohet përmes zbatimit të legjislacionit vendor. Sidoqoftë, shumë studiues dhe gjykata kanë argumentuar se, të paktën, një pjesë e DUDNJ-së që nga miratimi i saj janë bërë e drejtë zakonore ndërkombëtare, megjithëse kjo pikëpamje nuk është aspak universale.<sup>8</sup> Në disa vende, përdorimi i Deklaratës si ligj zakonor ka qenë i kufizuar në interpretimin e të drejtës së brendshme ose të traktateve ndërkombëtare, por në disa të tjera, pjesë të Deklaratës janë zbatuar drejtpërdrejt.<sup>9</sup>

### **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një traktat i gjerë që synon të mbrojë të drejtat e njeriut dhe liritë politike në të gjithë Europën. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë shtete palë të KEDNJ-së. Konventa gjithashtu ka krijuar Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), e cila lejon çdo individ, që beson se të drejtat e tij/saj janë shkelur, të dërgojë një rast në Gjykatën në Strasburg.

Zbatimi i KEDNJ-së nga autoritetet kosovare mbështet pohimet e vëzhguesve ndërkombëtarë se Kosova ka ndërtuar një sistem ligjor të modelit evropian. Me GjEDNJ që shërben si mishërim i të drejtave kushtetuese të njeriut në Kosovë, përpjekjet e ndërtimit të shtetit të ri do të ndikohen nga një sistem më evropian i të drejtave. Personat në Kosovë, përmes nenit 22.2, mund të pretendojnë se të drejtat dhe liritë e përmbajtura në Konventë si të drejta dhe liri kushtetuese, të cilat Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjithashtu i ka pohuar shprehimisht.<sup>10</sup> Megjithatë, ky pretendim nuk mund të zgjerohet për të përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ). Kushtetuta e Kosovës i detyron institucionet e Kosovës, duke përfshirë gjykatat e saj, të përdorin praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së si bazë për interpretimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese të njeriut. Megjithatë, praktika gjyqësore nuk është drejtpërdrejtë efektive brenda sistemit ligjor të Kosovës. Qytetarët kosovarë gjithashtu nuk mund të dërgojnë/adresojnë një rast para gjykatës së Strasburgut në rastin kur ata mendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga shteti. Gjithsesi, një person mund të pretendojë se interpretimi i një gjykate vendase mbi një të drejtë ose liri ka shkelur Kushtetutën nëse vendimi nuk ka përfshirë një rishikim të përmbajtjes eksplicite të praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së.<sup>11</sup>

### **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)**

KNDCP zoton dhe obligon palët për respektimin e të drejtave civile dhe politike të individëve, duke përfshirë, ndër të tjera, të drejtën për jetë, lirinë e fesë, lirinë e fjalës, lirinë e tubimit, të drejtat zgjedhore dhe të drejtat për proces të rregullt dhe gjykim të drejtë. Sistemi i raportimit të KNDCP-

<sup>6</sup> R. B., Lillich, “Thirrja në të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut në Gjykatat Vendore”, Rishikimi i Ligjit të Universitetit të Cincinnatit 54 (1985) faqet 367 – 415.

<sup>7</sup> Ibidem.

<sup>8</sup> Ibidem and Hannum H. 1995. “Statusi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare”. Gazeta e Gjeorgjisë për Ligjin Ndërkombëtar dhe Krahasues 25, faqet 287-397.

<sup>9</sup> H. Hannum, “Statusi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare”. Gazeta e Gjeorgjisë për Ligjin Ndërkombëtar dhe Krahasues 25 (1995) faqet 287 – 397.

<sup>10</sup> Fisnik Korenica & Dren Doli, “Kujdesi i Strasburgut: Statusi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Sistemin Ligjor të Kosovës”, Shqyrtimi i Ligjit të Liverpulit 32 (2011) fq. 216.

<sup>11</sup> Ibidem, 221.

së mund të konsiderohet si një mekanizëm llogaridhënie nëpërmjet të cilit një organ i OKB-së jep një llogari për mbrojtjen e të drejtave të njeriut përballë organeve të tjera të OKB-së, të gjitha shteteve anëtare të OKB-së, shteteve përkatëse dhe publikut në përgjithësi.<sup>12</sup> Këshilli i të Drejtave të Njeriut ("KDNj") vendosi të kërkojë dorëzimin e raporteve nga UNMIK-u sipas nenit 40 të KNDCP-së gjatë Sesionit të 81-të të tij në korrik të vitit 2004. Më pas, KDNj i ka bërë rekomandime autoriteteve në Kosovë në kohë përkatëse, duke përfshirë UNMIK-un, Forcën e Kosovës (KFOR-in) dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-ve). Për sa i përket monitorimit të Vëzhgimit Përfundimtar të vitit 2006, UNMIK-ut i është kërkuar të mbajë të informuar KDNj-në për tri çështje: krimet e rënda, siç janë krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krimet etnikisht të motivuara; zhdukjet dhe rrëmbimet, dhe masat e ndërmarrja për t'i adresuar ato; dhe kthimin e personave të zhvendosur dhe mjetet juridike për ta. Komiteti shprehu shqetësime lidhur me zbatimin e neneve 2 (3), 6 dhe 7 të KNDCP-së. Si përgjigje, UNMIK-u identifikoi një departament përgjegjës për ndjekjen e këtyre krimeve duke dhënë shembuj të rasteve të tilla.<sup>13</sup>

Protokolli i parë fakultativ (jo i detyrueshëm) i KNDCP-së, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1966, krijon një mekanizëm të veçantë ankimi që u lejon individëve, të cilët mendojnë se u janë shkelur të drejtat, të adresojnë ankesat në Komisionin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Kjo përfshinë 116 shtete palë, duke përfshirë pothuajse jurisprudencën e të gjitha shteteve të Europës, të Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Kosova, duke mos qenë shtet anëtar i OKB-së, nuk është palë në këtë protokoll.

### **Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMPK)**

KKMPK synon të promovojë barazinë e plotë dhe efektive të njerëzve që u përkasin pakicave kombëtare në të gjitha sferat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, së bashku me kushtet që do t'u lejojnë atyre të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre. Kosova i nënshtrohet një marrëveshjeje të veçantë monitorimi në lidhje me KKMPK-së, e nënshkruar ndërmjet UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës (KiE). Çdo pesë vjet, UNMIK-u dorëzon një raport që shqyrtohet nga një komision i pavarur, pas të cilit miratohet një rezolutë që përmban konkluzione dhe rekomandime për Kosovën në lidhje me zbatimin e KKMPK-së.<sup>14</sup> Ndikimi i KKMPK-së është shumë i dukshëm në Ligjin për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Shumë nga nenet janë formuluar përgjatë vijave të përgjithshme të KKMPK-së ose kopjojnë formulimin fjalë për fjalë. Kjo është veçanërisht e saktë për sa i përket dispozitave mbi identitetin (neni 2), kulturën (neni 3) dhe gjuhët (neni 4).<sup>15</sup>

### **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEGjFDR) dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGjFDG)**

Ligji i Kosovës mbi barazinë gjinore, miratuar në vitin 2015, në nenin 1 thekson se është në përputhje me KEGjFDG-në. Përveç kësaj, 'Ligji kundër diskriminimit', i cili u miratua në shkurt të vitit 2004, mund të konsiderohet si shumë i avancuar dhe i ngjashëm me KEGjFDR. Qëllimi i tij konsiderohet 'jashtëzakonisht i gjerë' pasi që ndalon jo vetëm diskriminimin e drejtpërdrejtë por edhe të tërthortë.<sup>16</sup>

<sup>12</sup> Erika Nakamura, "Monitorimi i llogaridhënies për Paqeruajtjen e OKB-së sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike", *Ditari nordik i së drejtës ndërkombëtare* 86 (2017) faqe 348.

<sup>13</sup> *Ibidem*, 352.

<sup>14</sup> Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, *Komunitete në Kosovë: Udhëzues për profesionistët që punojnë me komunitetet në Kosovë* (Prishtinë 2013) fq. 65.

<sup>15</sup> Emma Lantscher, "Mbrojtja e Komuniteteve Minoritare në Kosovë: Ligjërisht para Standardeve Evropiane - Praktikiht ende një rrugë e gjatë për ta kaluar", *Shqyrtimi i Ligjit për Europën Qendrore dhe Lindore* 33 (2008) 456.

<sup>16</sup> Emma Lantscher, "Mbrojtja e Komuniteteve Minoritare në Kosovë", fq. 458.

### **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)**

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës përmban 54 nene që detajojnë të gjitha aspektet e jetës së fëmijës, duke përcaktuar të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore që të gjithë fëmijët kudo që jetojnë kanë të drejtë. Përputhshmëria dhe pajtueshmëria monitorohet nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, i cili përbëhet nga anëtarë të vendeve të ndryshme të botës. Komiteti i paraqet një raport vjetor Komitetit të tretë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, i cili miraton një rezolutë mbi këtë bazë.

### **Konventa Kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar KKTTNMÇP**

Qëllimi kryesor i kësaj konvente është ndalimi i përdorimit të torturës dhe veprimeve të ngjashme; Konventa gjithashtu vendos një detyrim ndaj palëve shtetërore për të parandaluar transportimin e individëve në ndonjë vend ku ka gjasa të torturohen. Shumica dërmuese e dispozitave të traktatit janë mjaft të sakta për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti në Kosovë. Ligji për Avokatin e Popullit, i miratuar në vitin 2015, parasheh krijimin e një mekanizmi të veçantë brenda Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili kryen të gjitha funksionet e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (MKPT).<sup>17</sup> MKPT funksionon në përputhje me parimet e Konventës kundër torturës.

### **Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (KEGjRM)**

KEGjRM u nënshkrua në vitin 1992 nën kujdesin e KiE-së, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së gjuhëve të pakicave dhe atyre rajonale evropiane. Dokumenti konsideron se promovimi i gjuhëve dhe kulturave të pakicave duhet të shihet si një mjet për nxitjen e mirëkuptimit të ndërsjellë midis komuniteteve dhe jo si një mbrojtje e njëanshme e pakicave kundër interesit të shumicës. Karta thekson se "*çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të lirë dhe pa ndërhyrje në gjuhën amtare të tij respektivisht të pakicës së cilës i përket.*"<sup>18</sup> E drejta për arsim në njërën nga gjuhët e pakicave dhe përdorimi i asaj gjuhe mund të shihet si një trampolinë drejt një pjesëmarrje më të plotë dhe më kuptimplote të të dyja komuniteteve shumicë dhe pakicë. Prandaj, përgjegjësia e autoriteteve të Kosovës nuk duhet të jetë një promovim i paqartë i gjuhëve të pakicave, por një respekt i plotë për gjuhët e pakicave në marrëdhëniet e tyre me pjesëtarët e komuniteteve pakicë.<sup>19</sup>

<sup>17</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti i Parë Vjetor i Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (Prishtinë 2017) fq. 6.

<sup>18</sup> Këshilli i Evropës, Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare (Strasburg 1992) Neni 10.1.

<sup>19</sup> ECMI Kosova, komunitetet në Kosovë,66.

### Vështirësitë e zbatimit të drejtpërdrejtë

Pa dyshim, përkushtimi kushtetues i Kosovës ndaj të drejtave të njeriut është i admirueshëm dhe se përmbajtja e Nenit 22 për aplikimin e drejtpërdrejtë të tetë marrëveshjeve dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare tregon një angazhim të vërtetë të Kosovës (të paktën në letër). Sidoqoftë, përkundër qëllimeve qartësisht pozitive në lidhje me tetë marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, nuk mund të anashkalohet që ky zbatim i drejtpërdrejtë nuk pasqyron kuadrin ligjor që këto marrëveshje detyrojnë shtetet nënshkruese të këtyre marrëveshjeve. Kjo situatë sjell probleme qenësore, sepse qëllimi i këtyre traktateve është krijimi i “jo vetëm të drejtave kontingjente të dhëna nga vullneti i mirë i shteteve sovraane”, por “i të drejtave të patjetërsueshme të cilat ... nuk janë më në dispozicion të shteteve por janë pjesë e të drejtës ndërkombëtare që u japin të drejta të drejtpërdrejta individëve”.<sup>20</sup> Përderisa Neni 22 krijon një sistem të jashtëm të të drejtave duke përfshirë edhe të drejtat përkatëse, duke i dhënë efekt të detyrueshëm me prioritet një game të gjerë të të drejtave të përfshira në sferën ndërkombëtare, kjo është disi e dobësuar nga fakti se këto të drejta do të interpretohen vetëm nga gjykatësit vendor. Kjo do të thotë që justifikimi vendimtar për traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut - përgjegjësia e jashtme e shtetit - nuk është përmbushur.

Vështirësitë e integritetit të drejtpërdrejtë të TNDNj-ve në kuadrin vendor të Kosovës janë evidentuar shumë herë. Kjo veçanërisht në lidhje me marrëdhëniet kushtetuese të Kosovës me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Konventa është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i gjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë. Nënshkruar pasluftës së dytë botërore, respektivisht në vitin 1950, është e qartë se dokumenti ka pas për qëllim të parandalojë shtypjen e individëve dhe grupeve nga shtetet tiranike duke u ofruar atyre një gjykatë të jashtme e cila do t'i detyronte ligjërisht këto të fundit. Kjo u realizua nëpërmjet mekanizmit të Gjykatës europiane të të drejtave të njeriut. Kjo u realizua nëpërmjet mekanizmit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Rastet kryesore të referuara nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me përdorimin e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së janë rastet e vitit 2009 — Ibrahimimi dhe të tjerët kundër Gjykatës Supreme<sup>21</sup> dhe Kastrati kundër Gjykatës Supreme dhe vendimi i vitit 2010 – Bislimi kundër MI dhe të tjerëve.<sup>22</sup> Një analizë e këtyre rasteve tregon një model të qëndrueshëm të interpretimit të nenit 53 të Kushtetutës nga Gjykata. Neni 53 thekson se “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut”. Në rastin Ibrahimimi, Gjykata Kushtetuese e pranoi detyrimin e saj për t’iu referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, por nuk kishte konsideruar vetveten të detyruar të ndiqte vendimet e GjEDNj-së (megjithëse e kishte bërë këtë me qëllim të qartësimin të një dispozite kushtetuese dhe ka përdorë sqarime të tilla si një mjet për të racionalizuar kursin e arsytimit që ka pasuar). E njëjta linjë arsytimi mund të vërehet edhe në rastin Kastrati, ku Gjykata ka ndjekur një qasje, edhe një herë, për të demonstruar se ishte e detyruar t’i referohej praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, por në të vërtetë nuk ishte e lidhur me vendimet e saj. Në rastin Bislimi të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese shkoi më tej dhe në të

<sup>20</sup> August Reinisch, “Korniza ligjore ndryshuese ndërkombëtare për trajtimin e aktorëve jo shtetërorë ose palëve jon-nënshkruese”, në: Philip Alston ed. Aktorët jo shtetërorë dhe të drejtat e njeriut (Kurse të Akademisë së së Drejtës Evropiane 2005) fq. 38

<sup>21</sup> Ibrahimimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI 40/09, 2009, Gjykata Kushtetuese e Kosovës,;

<sup>22</sup> Bislimi v. MI et al., KI 06/10, 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës;

vërtetë përdori praktikën gjyqësore të GjEDNj-së për të kualifikuar faktet dhe për të përcaktuar specifikat e çështjes. Megjithatë, arsyetimi i saj tregon se nuk e bëri një gjë të tillë jashtë detyrës - Gjykata nuk e konsideronte veten të detyruar të bazonte vendimin e saj mbi praktikën gjyqësore të GjEDNj-së.<sup>23</sup>

Të tre rastet, pra, sugjerojnë një prirje apo trend të ndërmarrë nga ana e Gjykatës që të konsiderojë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së si një mjet për avancimin e interpretimit të dispozitave kushtetuese, dhe jo si një detyrim që kërkon respektimin e precedenteve të GjEDNj-së. Në mënyrë kritike, Gjykata Kushtetuese nuk është në gjendje të shqyrtojë tërësinë e jurisprudencës së GjEDNj-së, prandaj vetëm shqyrton një pjesë të praktikës së saj gjyqësore; kjo është e pamjaftueshme për përcaktimin e natyrës së vërtetë të ligjit apo praktikës së GjEDNj-së dhe për një rezultat të saktë bazuar në aplikimin e saj ndaj fakteve.<sup>24</sup> Kjo në mënyrë efektive do të thotë që ligji i Kosovës për të drejtat e njeriut nuk mund të konsiderohet se pasqyron cilësinë jurisprudenciale të GjEDNj-së. Praktikisht, kjo minon të drejtat e njeriut në Kosovë dhe mund të çojë në shkelje të pa-korrigjuara të të drejtave të individëve.

Një çështje tjetër me përfshirjen e drejtpërdrejtë të TNDNj-ve është nënvlerësimi i veprimeve të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre traktateve. Sa i përket Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në praktikë është arritur pak progres në zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit në Kosovë. Sipas një raporti të Komisionit Evropian, "shumë shpesh, njerëzit nuk janë në dijeni dhe nuk i kuptojnë konceptet e tilla si, bie fjala, "diskriminimi i tërthortë" ose "masat afirmative" dhe nuk janë në gjendje të identifikojnë diskriminimin si të tillë. Për më tepër, autoritetet ekzekutive nuk janë gjithmonë në gjendje t'i zbatojnë këto koncepte në praktikë, edhe nëse e dijnë në teori se çfarë do të thonë këto koncepte."<sup>25</sup> Institucioni i Ombudspersonit mund të luajë një rol në zbatimin e këtij ligji, por autoriteti i këtij institucioni është i kufizuar. Sipas hulumtueses Emma Lantscher, duket qartë se kuadri ligjor është i avancuar, por zbatimi praktik mbetet shumë prapa. Problemi kryesor në Kosovë me Ligjin kundër diskriminimit është mungesa e informimit publik, mungesa e internacionalizimit të parimeve të saj dhe mungesa e vullnetit politik për t'i dhënë përparësi zbatimit të këtij ligji.<sup>26</sup>

Problemi i zbatimit të ligjeve është gjithashtu çështja më pezull që pengon efektivitetin e KDF të KB-ve në Kosovë. Sipas Childpact, ekziston kuadër i duhur ligjor për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, por ky kuadër ligjor ekziston vetëm në letër. Legjislacioni përkatës shpërndahet përmes disa ligjeve, akteve nënligjore dhe politikave të ndryshme, duke qenë se Kosova nuk ka pasur një ligj të veçantë për të drejtat e fëmijës. Ky fragmentim i ligjeve që rregullojnë çështjet që ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e fëmijëve është parë si një mangësi ligjore, pasi mungesa e një ligji të plotë ka lënë fëmijët në një situatë të ndjeshme dhe të pasigurisë ligjore. Për të adresuar këtë problem, në vitin 2013 është filluar me hartimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Edhe gjatë këtij viti, Projektligji nuk u miratua në Kuvend.<sup>27</sup> Trafikimi i fëmijëve dhe puna e fëmijëve janë dy çështje me prioritet të lartë që kërkojnë më shumë veprime nga Qeveria e Kosovës. Me Indeksën e Mbrojtjes së Fëmijëve 2.0, i cili u lançua në janar të vitit 2018, OJQ-të Childpact dhe World Vision vazhdimisht monitorojnë progresin e Kosovës në këtë drejtim. Këshilli për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijët, Komiteti i Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve dhe Autoriteti Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore duhet të operacionalizohen dhe fuqizohen. Megjithatë,

<sup>23</sup> Paul de Hert, "Kushtetuta e Re e Kosovës", 161.

<sup>24</sup> Ibidem, 162.

<sup>25</sup> Ibidem, 460.

<sup>26</sup> Ibidem, 461.

<sup>27</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2017 (Prishtinë 2018) fq. 54.

është e drejtë të thuhet se Qeveria e Kosovës, në mënyrë të konsiderueshme, ka vënë si prioritet përpjekjet e saj për të krijuar legjislacionin adekuat në lidhje me drejtësinë për të mitur në nivel e politikave vendore.<sup>28</sup>

Një problem tjetër me zbatimin e drejtpërdrejtë sipas Kushtetutës është se kjo shpesh nuk merr parasysh nevojën për veprim të mëtejshëm dhe përmirësim nga ana e shtetit për të miratuar traktatin. Për shembull, një problem i rëndësishëm me Konventën Kornizë të KiE-së për Pakicat Kombëtare që zbatohet në Kosovë rezulton që Konventa në asnjë mënyrë, asnjëherë nuk e definon termin "pakicë kombëtare".<sup>29</sup> Do të dukej e qartë se në Kosovë termi "pakicë kombëtare" duhet të jetë sinonim i termit "komunitet" siç përcaktohet në amendamentin e vitit 2011 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë.<sup>30</sup> Megjithatë, meqënëse termi "pakicë kombëtare" nuk përdoret kurrë në legjislacionin kosovar, do të ishte e nevojshme për tu dhënë disa sqarime zyrtare të kësaj ekuivalence. Kjo do të pasonte shembullin e shteteve si Mbretëria e Bashkuar, e cila kur ratifikoi Konventën Kornizë specifikonte se termi "pakicat kombëtare" duhet të kuptohet për t'iu referuar "grupeve racore" siç përcaktohet në Seksionin 3 (1) të Aktit të Marrëdhënieve Racore të vitit 1976 dhe më pas ka njoftuar për shtimin e "grupit racor" Cornish në këtë kategori.<sup>31</sup> Në një mënyrë të ngjashme, ndërsa Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare përmban disa dispozita që janë të detyrueshme për të gjitha palët (Pjesa II), pjesa kryesore e marrëveshjes (Pjesa III) përbëhet nga mbi 100 masa, nga të cilat shtetet obligohen të zgjedhin vetëm një minimum prej 35 prej tyre për t'i zbatuar. Karta është hartuar në këtë mënyrë për të krijuar fleksibilitet maksimal, duke i lejuar shteteve të zgjedhin ato masa që përshtaten me rrethanat e gjuhëve të tyre të veçanta të pakicave. Si e tillë, kur shtetet kanë aderuar në traktat, ato kanë specifikuar cilat klauzola do të zbatohen në cilat gjuhë, shpesh duke aplikuar masa të ndryshme masash për çdo gjuhë në territorin e tyre.<sup>32</sup> Meqënëse kushtetuta e Kosovës nuk përmend asnjë dispozitë specifike të Kartës ose nuk specifikon se në cilat gjuhë aplikohet Karta, është e paqartë se në ç'mënyrë Karta mund të konsiderohet pjesë e kornizës së brendshme ligjore të Kosovës. Ky është një ilustrim tjetër i vështirësive në lidhje me angazhimin kushtetues të Kosovës sipas nenit 22 për të aplikuar drejtpërdrejtë tetë TNDNJ-të pa sqaruar më shumë për këtë, veçanërisht në lidhje me qëllimet dhe origjinalitetin dhe veçoritë e secilit dokument.

## Zbatimi i TNDNJ-ve në Kosovë

Shumica e TNDNJ-ve përfshihen në nenet e tjera të Kushtetutës së Kosovës ose në ligje të veçanta vendore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se zbatimi i këtyre traktateve është i mjaftueshëm ose se legjislacioni është i qartë. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) vuri në dukje se kur marrin një vendim, gjykatat rrallë i referohen këtyre traktateve. Edhe kur kjo ndodh, referencat janë të përgjithësuara dhe nuk janë konkrete në lidhje me rrethanat e rastit.<sup>33</sup> Falë intervistave që ECMI

<sup>28</sup> N.N., "Të drejtat e fëmijëve në Kosovë nuk duhet të ekzistojnë vetëm në letër", internet: ChildPact, 19 prill 2017, <http://www.childpact.org/2017/04/19/3811/>.

<sup>29</sup> Kinga Gál, "Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe ndikimi i saj në Evropën qendrore dhe lindore", Gazeta për Etnopolitikën dhe Çështjet e Pakicave në Evropë 1 (2000) faqe 1 - 17.

<sup>30</sup> "Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përcaktohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore ose fetare që janë tradicionalisht të pranishme në Kosovë dhe që nuk janë në shumicë. Këtu bëjnë pjesë serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, goranët, malazezët, kroatët dhe komunitete të tjera".

<sup>31</sup> Cahal Milmo, "Komuniteti Cornish të njihet si një pakicë kombëtare së bashku me skocezët, uellsianët dhe irlandezët", faqja e internetit të revistës – The Independent, 23-04-2014, <http://www.independent.co.uk/news/uk/politics/cornish-people-formally-declared-a-national-minority-along-with-scots-welsh-and-irish-9278725.html>.

<sup>32</sup> Mairead Nic Craith, "Lehtësimi ose Gjenerimi i Diversitetit Gjuhësor: Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare", në: Gabrielle Hogan-Brun & Stefan Wolff ed., Gjuhët e Minoriteteve në Evropë. Kornizat, Statusi, Perspektiva (Londër) 2003) faqe 56-72.

<sup>33</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti Vjetor 2017 (Prishtinë 2018) 26.

Kosova ka zhvilluar me disa ekspertë të nivelit të lartë, si bie fjala Institucionin e Avokatit të Popullit dhe UNDP-në, me studentë të drejtësisë në fakultetin juridik të Universitetit të Prishtinës, me avokatë dhe përfaqësuesë të shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesë të Gjykatës Kushtetuese dhe Akademisë së Drejtësisë, janë identifikuar dy arsye kryesore për joefikasitetin në sistemin aktual gjyqësor. Këto janë mungesa e ekspertizës në lidhje me natyrën e ligjeve ndërkombëtare, dhe mangësitë e kapacitetit dhe transparencës brenda sistemit gjyqësor.

## Mungesa e ekspertizës në të drejtën ndërkombëtare

Mungesa e njohurive të ekspertëve lidhur me të drejtën ndërkombëtare brenda sistemit gjyqësor dhe, më tej, komunitetit ligjor të Kosovës si tërësi është një pengesë e madhe për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut. Laura Dickinson ka vërejtur se “edhe kur gjykatat vendore janë të autorizuara, sipas ligjit vendor, për të zbatuar të drejtën ndërkombëtare humanitare, shpesh vërehet se ekziston një kufizim i njohjeve mbi normat në fjalë, një autoritet i tillë është i pakuptimtë”.<sup>34</sup> Kohët e fundit, Grupi për Studime Ligjore dhe Politike ka theksuar se megjithëse këto instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë të përfshira në Kushtetutën e Kosovës, ato mbeten të papërdorura.<sup>35</sup> Si e tillë, është e nevojshme që gjyqtarët dhe avokatët kosovarë të njihen dhe familjarizohen me shkallën e plotë dhe implikimet e dispozitave të të drejtave të njeriut në Kushtetutë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh rolin në rënie të gjyqtarëve të huaj në sistemin ligjor të Kosovës dhe faktin se kosovarët aktualisht nuk kanë qasje në mekanizmat e ankesave dhe të zbatimit siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) dhe komitetet e ndryshme të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, popullata në përgjithësi duhet të jetë më mirë e informuar për të drejtat e njeriut, veçanërisht në zonat ku vazhdon të ketë probleme serioze. Duhet të bëhen përpjekje të veçanta për të siguruar që pjesëtarët e pakicave etnike të marginalizuara të informohen për të drejtat e tyre si qytetarë kosovarë.<sup>36</sup>

Qytetarët duhet të informohen më mirë për të drejtat ligjore që garantohen nga TNDNJ-të. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rritjes së vetëdijes për ekzistencën e traktateve dhe mënyrën se si ato mund të përdoren në gjykatë. Dispozitat e TNDNJ-ve që nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë<sup>37</sup> duhet të realizohen përmes zbatimit të mekanizmave të traktateve në legjislacionin vendor. Pas kryerjes së disa intervistave cilësore me ekspertë ligjorë të nivelit të lartë që përfaqësojnë disa nga institucionet më të rëndësishme, mund të konsiderohet se ekzistojnë tre komponentë kryesorë në lidhje me mungesën e ekspertizës, të cilat të gjitha mund të lidhen me natyrën e arsimit ligjor të Kosovës.

## Akademia e Drejtësisë

Në shkurt të vitit 2017 Instituti Gjyqësor i Kosovës u shndërrua në Akademinë e Drejtësisë. Akademia është përgjegjëse për trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të gjykatave në Kosovë. Çdo vit, programi i Akademisë zhvillohet duke diskutuar se cilat janë nevojat dhe çfarë do të jetë fokusi i saj specifik. Këto diskutime po bëhen me disa bashkëbisedues, siç janë gjyqtarët, gjykatat përkatëse dhe pale të tjera të interesit. Raportet si Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën gjithashtu merren parasysh nëse ka ndonjë rekomandim. Për vitin 2018, ekzistojnë katër trajnime specifike në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm të Akademisë (PTV) që fokusohen në të drejtën ndërkombëtare, përkatësisht nenet 2, 5, 6 dhe

<sup>34</sup> Laura Dickinson, “Premtimi i gjykatave hibride”, Ditari Amerikan mbi të drejtën ndërkombëtare 97 (2003) faqet 295 – 310.

<sup>35</sup> Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, *Rruga e Kosovës drejt Këshillit të Evropës: Identifikimi i procedurave, pengesave dhe zgjidhjeve për anëtarësim (Prishtinë 2013)*.

<sup>36</sup> Ibidem.

<sup>37</sup> Për shkak se Kosova nuk është njohur si shtet i pavarur nga BE dhe OKB.

8 të KEDNj-së. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që këto janë nenet e vetme që mësohen. Sipas Akademisë së Drejtësisë, ligjet ndërkombëtare po merren parasysh dhe integrohen në disa trajnime për raste më specifike dhe praktike. Në vitin 2017, PTV-të u përqendruan në nenet 6 dhe 10, por Akademia nuk e di nëse ka pasur një tendencë më të madhe të përqendrimit në ligjet ndërkombëtare në vitet e fundit, pasi për këtë gjë nuk është bërë ndonjë vlerësim.

Kjo vëmendje, disi e kufizuar, ndaj ligjeve ndërkombëtare pranohet nga vetë Akademia. Gjykatësit i japin përparësi ligjeve vendore, duke parë këto si të përshtatshme dhe të mjaftueshme për gjykimin e tyre, kryesisht sepse, siç u tha më lart, Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe BE-së dhe për këtë arsye nuk është pjesë e mekanizmave të saj. Përderisa Akademia përpiqet të inkorporojë ligjet ndërkombëtare në trajnimet e tyre, sipas Institucionit të Avokatit të Popullit, duket se ndikimi praktik është i kufizuar. Gjyqtarët në Kosovë rrallë posedojnë njohuritë e rëndësishme speciale mbi të drejtën ndërkombëtare, me qëllim që të përfshihen TNDNj-të brenda vendimeve të tyre. I vetmi Traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që është i përfshirë në programet mësimore është KEDNj dhe ky mësim është i kufizuar në vetëm disa nene. Argumenti se TNDNj-të janë të integruara në legjislacionin vendor është i kuptueshëm, por kjo vë re që zbatimi i një legjislacioni të tillë është i pamjaftueshëm. Gjykatësit nuk janë të familjarizuar me kontekstin e këtyre ligjeve dhe nuk përmendin asnjë koment të rasteve të veçanta në gjykimet e tyre.

### **Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës**

Mungesa e ndërgjegjësimit brenda sistemit gjyqësor të Kosovës mbi natyrën e të drejtës ndërkombëtare, veçanërisht atë që përfshihet në kushtetutë sipas nenit 22, kërkon shpjegime të mëtejshme. Kjo mungesë e ndërgjegjësimit mund të konsiderohet si pasqyrim i një mospërputhjeje më të gjerë brenda sferës ligjore të Kosovës si e tërë, gjë që kërkon ndryshime të rëndësishme. Në Universitetin e Prishtinës, drejtimi mbi të "drejtën ndërkombëtare" ka rëndësi nga këndvështrimi i fakultetit: Provimi mbi të drejtat e njeriut/të drejtës ndërkombëtare ligjohet për tre orë në javë gjatë një semestri. Vlerësimet për këtë provim janë relativisht të thjeshta, çka çon në bindjen se ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut nuk ka rëndësi relative; për më tepër, kjo do të thotë që studentët kanë njohuri të kufizuara të subjektit në tërësi. Studentët kanë pohuar se ekziston një fokus shumë i madh në teori sesa në praktikë në kuadër të fakultetit të drejtësisë; për të kuptuar me të vërtetë TNDNj-të, studentët duhet të lexojnë dhe analizojnë rastet, siç janë ato të GjEDNj-së. Drejtuesit e Fakultetit e pranojnë këtë problem, por shpjegojnë një pengesë në faktin që komentet e traktateve ofrohen vetëm në gjuhën angleze. Për më tepër, fakulteti si dhe studentët pajtohen se mungojnë profesorët e kualifikuar që i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme të drejtës ndërkombëtare. Mundësitë për të mësuar apo angazhim praktik dhe mbërritje të përvojës gjithashtu duhet të zgjerohen. Aktualisht rreth 350 studentë në vit kryejnë praktika në gjykata të ndryshme; megjithatë, fakulteti duhet të ofrojë mundësi të mëtejme për studentët që të marrin pjesë në gjykata dhe procedime gjyqësore. UNDP thotë se profesorët duhet t'i ftojnë gjykatësit gjithnjë e më shumë në mësimet e tyre për të folur për përvojat e tyre në praktikat gjyqësore. Një problem tjetër që pengon sistemin arsimor të Kosovës është mungesa e materialeve të duhura në lidhje me TNDNj-të dhe ligjet ndërkombëtare në përgjithësi. Fakultetet e shumta merren me problemet në aspektin e kapaciteteve. Sipas fakultetit, profesorët japin tre kurse apo provime për një semestër, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për t'u përqendruar në temat që kanë rëndësi. Megjithatë, është e paqartë nëse personeli mësimdhënës ka punë të veçanta shtesë jashtë Universitetit në shkollat private, gjë që për shkak të mungesës së kohës do të pamundonte ata/ato për të bërë hulumtimet e tyre dhe për të planifikuar ligjeratat.



Studentët dëshirojnë të kenë më shumë seminare, në të cilat ata mund të shkëmbejnë pikëpamjet mbi atë që është dhe çfarë nuk është e rëndësishme, për shembull një mënyrë më praktike të mësimdhënies. Sipas fakultetit, kërkesat e studentëve po përmbushen dhe është rritur bashkëpunimi mes të dy palëve. Megjithatë, sipas studentëve, pranimi në shkollat e drejtësisë është relativisht i lehtë; kjo nuk është gjë e mirë për performancën e përgjithshme. Një numër më i vogël i studentëve do të pranonte madhësi më të vogla fizike të kabineteve dhe një mësimdhënie optimale. Është e drejtë të thuhet se Universiteti është duke marrë masa në këtë drejtim: Gjatë viteve ata kanë ulur numrin e studentëve të drejtësisë në Fakultetin Juridik nga 2.000 në 800 dhe kanë për qëllim të ulin numrin edhe më shumë. Sipas fakultetit, një çështje më e ngutshme apo urgjente është se ka katër universitete publike dhe së paku njëzet shkolla private, të cilat të gjitha ofrojnë kurse apo mundësi studimi për drejtësi. Ka shumë pak bashkëpunim mes tyre, gjë që rezulton në shumë-më-shumë studentë të drejtësisë që futen në tregun e punës në të njëjtën kohë.

### **Çështjet e gjuhës**

Sipas bashkëbiseduesve të ECMI Kosovës, gjyqtarët kosovarë shpesh nuk janë të informuar për atë se çka nënkuptojnë saktësisht ligjet ndërkombëtare dhe për këtë arsye shmangin rastet të përdorimit TNDNj-të në vendimet e tyre. Shumica e gjyqtarëve nuk janë në gjendje të përdorin komentet e traktateve që do të ishin një mjet i mirë për t'u përdorur në gjykatë, për shembull nga Ligjet e Strasburgut. Kjo ndodh për shkak se shumica e gjyqtarëve në Kosovë, me përjashtim të gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese, nuk flasin gjuhen angleze në një nivel të kënaqshëm për të kuptuar plotësisht dokumentet e parashikuara në nenet 22, 53 dhe 58 të Kushtetutës. Sipas Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, përkthimet e traktateve janë siguruar në mënyrë që njohuria e gjuhës angleze të mos jetë e detyrueshme. Megjithatë, megjithëse shumica e këtyre traktateve janë përkthyer në mënyrë të duhur në shqip dhe serbisht, për komentet nuk mund të thuhet e njëjta gjë, që ndikon që gjyqtarët të kanë vështirësi në paraqitjen e këtyre rasteve.

### **Mangësitë në Kapacitet dhe Transparencë**

#### **Proces i ngadalshëm i shqyrtimit të rasteve**

Një skepticizëm i përhapur lidhur me sistemin gjyqësor ekziston në opinionin e popullatës së përgjithshme të Kosovës. Kjo ndodh për shkak të trajtimit jashtëzakonisht të ngadalshëm të rasteve, të cilat shpesh zgjasin për vite të tëra me vonesa të përsëritura. Sipas raportit vjetor të vitit 2017 të Institucionit Avokatit të Popullit, qytetarët vazhdojnë të përballen me "vonesat e procedurave për shqyrtimin e çështjeve të tyre për vite, moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të plotfuqishme, vendime joefektive, parashkrimin e çështjeve gjyqësore, si dhe gabime në shënimet e tyre personale që ndikojnë në pamundësinë e realizimit të të drejtave të tyre ... që ka ndikim negativ në perceptimin e qytetarëve për drejtësinë dhe kështu ka krijuar mosbesim në sistemin gjyqësor për mungesën e objektivitetit të gjyqtarëve gjatë shqyrtimit të çështjeve të tyre ". Raporti më i fundit vjetor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës tregoi për 307,984 raste të pazgjidhura deri në fund të vitit 2017. Numri i rasteve të pazgjidhura në fund të vitit 2016 ishte 399,127, prandaj ka pasur një progres të konsiderueshëm në këtë drejtim. Sidoqoftë, kohët e pritjes së zgjidhjes së rasteve mbeten jashtëzakonisht të larta, pavarësisht kohës që duhet për të zgjidhur një rast. Sipas bashkëbiseduesve të ECMI, në Kosovë nuk është e pazakontë që rastet gjyqësore të zgjasin mesatarisht 8.5 vjet, që nuk është vetëm një periudhë shumë e gjatë, por gjithashtu kushton një shumë të konsiderueshme parash dhe është një barrë e madhe psikologjike për personin/palën që paraqet rastin.

Procedurat e komplikuar burokratike dhe mbingarkesat e mëdha të rasteve gjyqësore kanë bërë që shumë individë të mos jenë në gjendje të përfitojnë nga mjetet juridike civile për shkeljet e të drejtave të njeriut. Mbingarkesa e madhe e rasteve të pazgjdhura ka disa dimensione, duke përfshirë ndryshimet e mëdha ligjore, por gjithashtu mungesën e njohurive të specializuara lidhur me ligje të caktuara nga gjyqtarët dhe prokurorët, duke çuar në raste të pazgjdhura. Si rrjedhojë, rastet janë kaluar nga Gjykata në Gjykatë pa parë një përfundim pozitiv për to. Ngjashëm me institucionet e tjera të pavarura, Akademia e Drejtësisë e pranon këtë problem dhe ka organizuar disa tryeza të rumbullakëta dhe takime të përbashkëta në lidhje me këto çështje. Së shpejti Akademia do të publikojë një raport i cili synon të trajtojë shumë nga problemet ekzistuese dhe jep një udhëzim për gjyqtarët se si të merren me raste të ngjashme që kanë pasur rezultate të ndryshme në të kaluarën. Aktualisht, zgjatja e procedimit të rasteve është një problem ciklik. Si rezultat i presionit kohor për zgjidhjen e këtyre rasteve, gjyqtarët nuk janë në gjendje komfori për t'u trajnuar dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre për çështje të tilla si ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Kjo është një çështje strukturore e cila mund të rezultojë në një përmbajtje më të ulët të gjyqësorëve.

### **Mangësitë e kapaciteteve**

Procesi i ngadalshëm i shqyrtimit të rasteve ndodh pjesërisht për shkak të mungesës së personelit ligjor në institucionet gjyqësore të Kosovës. Në vitin 2017, kanë qenë vetëm 404 gjyqtarë aktivë dhe 40 bashkëpunëtorë profesionistë që kanë punuar në gjykata. Sipas Institucionit të AP-së, një rritje e numrit të personelit do të ishte shumë efektive në reduktimin e numrit të lëndëve të pazgjdhura gjyqësore. Për një periudhë të konsiderueshme, gjyqtarët po merren me çështje që janë jashtë mandatit të tyre si rezultat i kësaj mungese të personelit. Një zgjidhje mund të vijë nga shqyrtimi i tanishëm funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit në Kosovë, i cili është duke u administruara nga Ministria e Drejtësisë.

Megjithatë, Ministrisë së Drejtësisë i mungon kapaciteti për të administruar një detyrë të tillë si e vetme dhe Gjyqësori është në nevojë të dëshpëruar për më shumë bashkëpunëtorë ligjorë për t'u marrë dhe trajtuar numrin e madh të lëndëve të pazgjdhura. IAP dhe UNDP përmendin ndikimin e konsiderueshëm politik të Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të Gjyqësorit si një prioritet drejt jo-efikasitetit në këtë të fundit.<sup>38</sup> Ministria aktualisht ka një mandat për të krijuar politika, që kanë ndikim në sistemin gjyqësor. Kjo rrezikon ndarjen e pushteteve dhe prandaj, pavarësia e gjyqësorit ka qenë një problem në kërkimin e zgjidhjeve të qëndrueshme. Administrimi i drejtësisë ishte i ngadalshëm dhe nuk kishte mundësi të siguronte llogaridhënie nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat gjyqësore ishin subjekt i ndërhyrjes politike, me emërime të diskutueshme dhe mandate të paqarta.<sup>39</sup> Për shembull, emërimi i 53 gjyqtarëve të rinj në vitin 2016 u bë i diskutueshëm pasi Këshilli Gjyqësor i Kosovës, atëherë institucioni përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve, uli kërkesat në mes të procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj dhe më vonë e bëri ndryshimin, vendim ky që kishte ndikuar 75 kandidatët që fillimisht kishin kaluar testet kualifikuese.<sup>40</sup>

### **Çështjet e bashkëpunimit**

Sipas IAP-së duhet të ketë një grup punues i përbërë nga ekspertë ligjorë, që punojnë brenda gjyqësorit, në terren dhe në institucionet relevante për të bërë punën e Rishikimit Funksional. Një grupi të tillë pune duhet t'i lejohet kohë e mjaftueshme për të dalë me zgjidhje afatgjata, të qëndrueshme dhe drejtpërdrejtë të zbatueshme për sistemin gjyqësor. IAP deklaroi se nuk

<sup>38</sup> Intervistat me UNDP dhe Institucionin e Ombudspersonit, 2018

<sup>39</sup> USAID, Raporti i Kosovës për Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2017: Kosovë (2018), 10.

<sup>40</sup> Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, 'Kombet në Tranzit: Kosova 2018', faqja e internetit Freedom House, f. 12, [https://freedomhouse.org/sites/default/files/Ni2018\\_Kosovo.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/Ni2018_Kosovo.pdf).

është emëruar asnjë zyrtarë profesional për të kryer këtë shqyrtim të rëndësishëm; prandaj vetë institucioni nuk ishte i gatshëm të ofronte bashkëpunimin e nevojshëm. Megjithatë, Universiteti i Prishtinës deklaroi se ata janë pjesë e Rishikimit dhe se profesorët shpesh thirren për të dhënë mendimin e tyre dhe për të qenë pjesë e disa grupeve të punës. Përveç kësaj, UNDP deklaroi se kompetenca e lartë e IAP-së do të ishte mjaft e dobishme për ta bërë Rishikimin një sukses. Prandaj është për të ardhur keq që IAP nuk dëshiron të bashkëpunojë me Ministrinë e Drejtësisë. Për fat të keq, mosgatishmëria e IAP-së për të punuar me Ministrinë e Drejtësisë nuk është çështje e bashkëpunimit në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Për shembull, Universiteti i Kosovës ka një bashkëpunim të mirë kur bëhet fjalë për ftesën e gjyqtarëve për të dhënë ligjërata për studentët. Por anasjelltas, interesi nga ana e gjyqtarëve për të folur me profesorët se si duhet të formulohen politikat nuk është reciprok. Sipas Universitetit, bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit Juridik dhe Akademisë së Drejtësisë gjithashtu dëshmohej joproduktiv. Fakulteti Juridik thekson rëndësinë e ligjeve ndërkombëtare, por Akademia ka dështuar të transmetojë tek gjykatësit rëndësinë e këtyre ligjeve. Ekziston një bashkëpunim midis Universitetit dhe Akademisë, por Universiteti duket se është më i angazhuar për këtë; Akademia kryesisht dëgjon atë që dëshirojnë gjyqtarët, në vend që të marrë dhe shqyrtojë këshillën e Fakultetit. Në përgjithësi, kjo mungesë bashkëpunimi çon në jo-efikasitet në sistemin ligjor dhe në mënyrë të tërthortë dobëson thelbin e të drejtave të njeriut.

### **Mangësitë në transparencë**

Është një parim themelor i sundimit të ligjit që Qytetarët kanë të drejtë të dinë se çfarë bëjnë qeveritë e tyre dhe për këtë arsye kanë të drejtë të informohen për ligjet dhe vendimet për të njohur të drejtat dhe detyrimet e tyre. Në Kosovë, ligjet, aktet dhe marrëveshjet publikohen në faqen e internetit të Parlamentit dhe në Gazetën Zyrtare. Institucioni përgjegjës për këtë është Zyra për Botimin e Gazetës Zyrtare, e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Megjithëse publikohen të gjitha ligjet, këto nuk janë domosdoshmërisht lehtësisht të qasshme për publikun e gjerë. Amendamentet apo ndryshimet e ligjeve publikohen në gazeta të ndryshme; kur të miratohet një ligj i veçantë, publikohet në Gazetën Zyrtare të tremujorit të vitit që është miratuar. Por, kur bëhet një ndryshim i atij ligji, publikohet në një Gazetë tjetër. E njëjta vlen edhe për aktet nënligjore. Legjislacioni primar publikohet në internet në Gazetën Zyrtare, por legjislacioni sekondar publikohet vetëm kur Kryeministri e kërkon atë në mënyrë të veçantë. Shumica e legjislacionit dytësor publikohet në faqet e internetit të ministrive përkatëse dhe në Zyrën e Kryeministrit, por kjo ndonjëherë e bën të paqartë se ku mund të gjenden dokumente të caktuara.

Këto pabarazi kanë krijuar konfuzion në aspektin e qartësisë ligjore. Për shkak të mungesës së transparencës në procesin gjyqësor, është e vështirë për publikun, mediat dhe madje edhe anëtarët e tjerë të gjyqësorit që të gjykojnë me saktësi efektivitetin dhe drejtësinë e punës së gjyqësorit. Duket se ka një mosbesim të përgjithshëm për mediet midis gjykatësve dhe prokurorëve, duke rezultuar në një ngurrim për të dhënë informacion. Kjo, nga ana tjetër, ka kontribuar në zhvillimin e një imazhi negativ të gjyqësorit dhe shërbimeve të prokurorisë në media. Një marrëdhënie e dobët dhe antagonistike është zhvilluar mes medieve dhe institucioneve gjyqësore.<sup>41</sup> Një rritje në transparencën e procesit disiplinor gjyqësor do të ishte masë efektive në rritjen e besimit të publikut dhe rritjen e efikasitetit të gjyqësorit.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Integriteti Gjyqësor në Kosovë (2014) 31.

<sup>42</sup> Ibidem, 15.

Angazhimi kushtetues i Kosovës për disa Traktate të të Drejtave të Njeriut në Nenet 22, 53 dhe 58 është i admirueshëm. Megjithatë, duhet të theksohet se pa u bërë palë nënshkruese në këto traktate, efektiviteti i tyre i plotë nuk do të jetë i mundur dhe për këtë arsye mungon mbrojtja e të drejtave të njeriut. Në thelb të traktateve të tilla është ideja e një mekanizmi të jashtëm për të mbrojtur individin nga padrejtësitë e mundshme të shkaktuara nga shteti. Meqenëse zbatimi i këtyre traktateve në Kosovë realizohet me bazë brenda sistemit vendor, dhe se shumica e TNDNj-ve interpretohen vetëm nga gjykatësit vendor, nënkupton se mungon mbrojtja e vërtetë e të drejtave të njeriut.

Përveç këtij problemi, mund të konsiderohet se ekziston një hendek i rëndësishëm midis të drejtave të mbrojtura në teori nga kushtetuta e Kosovës dhe zbatimi i këtyre të drejtave në praktikë. Përveç mungesës së mekanizmave të jashtëm, mekanizmat e brendshëm të Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë të mangët. Bazuar në intervistat e ECMI Kosovës me disa ekspertë ligjorë të nivelit të lartë, mund të konsiderohet se ekzistojnë dy arsye kryesore pse Traktatet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (TNDNj) të përmendura në Nenin 22, 53 dhe 58 të Kushtetutës së Kosovës nuk zbatohen siç duhet.

Së pari, ekziston një mungesë njohurish për këto Traktate. Kjo pjesërisht i atribuohet faktit se Kosova nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, por është gjithashtu rezultat i një mungese të arsimit cilësor. Akademia e Drejtësisë nuk ofron shumë trajnime për ligjet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të gjyqtarëve kosovarë. Gjyqtarët nuk e kuptojnë përmbajtjen e TNDNj-ve dhe nuk i përdorin komentet e ligjeve përkatëse në gjykimet e tyre. Përveç kësaj, cilësia e mësimdhënies së të drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës duket e pamjaftueshme; studentëve nuk u ofrohen trajnime të mjaftueshme praktike për këto tema dhe ankohen se nuk janë në gjendje t'i bëjnë publik dhe të njohur interesat e tyre. Mungesa e shërbimeve të përgjithshme është gjithashtu një problem brenda fakulteteve përkatëse të drejtësisë për të ofruar arsim cilësor.

Mungesa e kapaciteteve dhe transparencës në të gjithë sistemin gjyqësor është problematike dhe ka çuar në një mosbesim ndaj sistemit gjyqësor në mesin e popullatës së Kosovës. Rastet në mesatare rreth 8.5 vite për t'u finalizuar, shpesh duke u kthyer mbrapa dhe duke u bartur mes gjykatave të ndryshme pa gjetur një zgjidhje. Mbingarkesa e madhe e rasteve dhe procedurat e komplikuar burokratike janë pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së bashkëpunëtorëve ligjorë që punojnë brenda sistemit gjyqësor. Ndikimi politik dhe korrupsioni brenda Gjyqësorit nuk ndihmon për të fituar besimin e qytetarëve ose për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet disa institucioneve e përkeqëson situatën. Problemi i gjetjes së ligjeve, akteve nënligjore dhe ndryshimeve pasuese të tyre është ende një problem i madh për të gjithë personat e përfshirë në gjyqësi. Kjo mungesë transparence ndikon në rezultate të ndryshme për raste të ngjashme, gjë që e bën jashtëzakonisht të vështirë për gjyqtarët që të marrin vendime të mira dhe meritore.

Duhet pranuar se të gjitha këto probleme janë strukturore dhe nuk do të zgjidhen brenda natës. Institucionet ligjore të Kosovës janë më pak se 20 vjeç dhe në të cilat kanë punuar një numër i madh i gjyqtarëve të jashtëm, jo-vendor, për një kohë të gjatë. Përveç kësaj, unifikimi i sistemit të drejtësisë për përfshirjen e gjyqtarëve serbë ka ndodhur vetëm në tetor të vitit 2017. Kjo nuk

do të thotë se duhet të pranohet ose të miratohet jo-efikasiteti i sistemit gjyqësor, veçanërisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo gjë më tepër nënkupton që për efekt të përmirësimit të efikasitetit dhe zbatimit efektiv të të drejtave të njeriut do të duhet kohë dhe një proces që kërkon ndryshime substanciale strukturore.

Përderisa mbeten mangësi të konsiderueshme në kuadrin e tanishëm të të drejtave të njeriut të Kosovës dhe marrëdhënieve të këtij kuadri me të drejtën ndërkombëtare, konsiderohet se ka shpresë të konsiderueshme për përmirësime dhe sukses në të ardhmen. Ndërsa Kosova po përparon drejt konsolidimit të shtetësisë së saj, kjo do të lejojë, eventualisht, pranimin e saj si në Këshillin e Evropës ashtu edhe në Kombet e Bashkuara.

## REFERENCAT

### Raporte Zyrtare dhe Dokumente dhe materiale të Politikave (Qeveria dhe OJQ-të):

AKTIV & CPT, *Dokument i shkurtër i politikave: Cilësia e Ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe* (Mitrovicë 2016).

Qendra e Energjise Civile, "*Dokument i shkurtër i politikave mbi Cilësinë e përkthimit të ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe*", faqja e internetit të Qendrës së Energjisë Civile, [http://civicenergycenter.org/en/empirica/policy\\_brief\\_on\\_the\\_quality\\_of\\_translation\\_of\\_kosovo\\_laws\\_into\\_serbian\\_language/249/](http://civicenergycenter.org/en/empirica/policy_brief_on_the_quality_of_translation_of_kosovo_laws_into_serbian_language/249/).

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, Komunitetet në Kosovë: *Udhëzues për profesionistët që punojnë me komunitetet në Kosovë* (Prishtinë 2013).

Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve (ECMI) në Kosovë, Dokument i shkurtër i politikave – *Niveli i njohjes dhe Përdorimi i Gjuhëve Zyrtare në komunat e Kosovës* (Prishtinë 2012).

Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, Rruga e Kosovës drejt Këshillit të Evropës: *Identifikimi i procedurave, pengesave dhe zgjidhjeve për anëtarësim* (Prishtinë 2013).

Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, "Kombet në tranzit: Kosova 2018", *faqja e internetit e Freedom House*, faqe 12, [https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018\\_Kosovo.pdf](https://freedomhouse.org/sites/default/files/NiT2018_Kosovo.pdf).

Kosovo Judicial Council, *Statistics of the Courts: Annual Report 2017* (Pristina 2018).

Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raport Vjetor 2017* (Prishtinë 2018).

Institucioni i Avokatit të Popullit, *Raporti i Parë Vjetor i Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës* (Prishtinë 2017).

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, *Raporti i Vlerësimit të të Drejtave të Komuniteteve, Edicioni i katërt* (Prishtinë 2015).

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, *Integriteti Gjyqësor në Kosovë* (2014).

USAID, *Raporti i Kosovës mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2017*: (Prishtinë 2018).

### Artikuj akademikë:

Adem Beha, "Të Drejtat e Pakicave: Një mundësi për përshtatjen e marrëdhënieve etnike në Kosovë?", *Gazeta mbi Etno-politikën dhe çështjet e pakicave në Evropë* 13 (2014) faqet 85 – 110.

Craith, Mairead Nic, "Lehtësimi ose Gjenerimi i Diversitetit Gjuhësor: Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare", në: Gabrielle Hogan-Brun & Stefan Wolff ed., *Gjuhët e Minoriteteve në Evropë. Kornizat, Statusi, Perspektiva* (Londër) 2003) faqe 56–72

Laura Dickinson, "Premtimi i gjykatave hibride", *Gazeta amerikane e së drejtës ndërkombëtare* 97 (2003) faqet 295 – 310.

Gál Kinga, "Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe ndikimi i saj në Evropën qendrore dhe lindore", *Gazeta për Etnopolitikën dhe Çështjet e Pakicave në Evropë* 1 (2000) faqe 1 - 17.

H. Hannum, "Statusi i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare". *Gazeta e Gjeorgjisë për Ligjin Ndërkombëtar dhe Krahasues* 25 (1995) faqet 287 – 397.

Paul de Hert & Fisnik Korenica, "Kushtetuta e Re e Kosovës dhe Marrëdhënia e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Kushtetutshmëria "Pa" Ratifikim në Shoqëritë Pas Konfliktit", *Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht* 76 (2016) faqet 143-166.

Fisnik Korenica & Dren Doli, "Kujdesi i Strasburgut: Statusi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Sistemin Ligjor të Kosovës", *Shqyrtimi i Ligjit të Liverpulit* 32 (2011) faqet 209 – 223.

Emma Lantscher, "Mbrojtja e Komuniteteve Minoritare në Kosovë: Ligjërisht para Standardeve Evropiane - Praktikohej ende një rrugë e gjatë për ta kaluar", *Shqyrtimi i Ligjit për Europën Qendrore dhe Lindore* 33 (2008) 451 - 490.

Lillich, R. B., "Thirrja në të Drejtën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut në Gjykatat Vendore", *Rishikimi i Ligjit të Universitetit të Cincinnatit* 54 (1985) faqet 367 – 415.

V. Morina dhe F. Korenica dhe D. Doli, "Marrëdhënia ndërmjet të drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës kombëtare në rastin e Kosovës: Një perspektivë kushtetuese", *Gazeta Ndërkombëtare e së Drejtës Kushtetuese* 9 (2011) faqet 274-296.

Erika Nakamura, "Monitorimi i llogaridhënies për Paqeruajtjen e OKB-së sipas Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike", *Ditari nordik i së drejtës ndërkombëtare* 86 (2017) 348.

August Reinisch, "Korniza ligjore ndryshuese ndërkombëtare për trajtimin e aktorëve jo shtetërorë ose palëve jon-nënshkruese", në: Philip Alston ed. *Aktorët jo shtetërorë dhe të drejtat e njeriut* (Kurse të Akademisë së së Drejtës Evropiane 2005) fq. 38

#### **Legjislacioni:**

Këshilli i Evropës, *Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare* (Strasburg 1992).

#### **Artikuj të shkurtër:**

Milmo, Cahal, "Komuniteti Cornish të njihet si një pakicë kombëtare së bashku me skocezët, uellsianët dhe irlandezët", faqja e internetit të revistës – *The Independent*, 23-04-2014, <http://www.independent.co.uk/news/uk/politics/cornish-people-formally-declared-a-national-minority-along-with-scots-welsh-and-irish-9278725.html>.

N.N., "Të drejtat e fëmijëve në Kosovë nuk duhet të ekzistojnë vetëm në letër", internet: *ChildPact*, 19 prill 2017, <http://www.childpact.org/2017/04/19/3811/>.

Die Morina dhe Labinot Leposhtica, "Marrëveshja për unifikimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë", faqja e internetit të *BalkanInsight* 17-10-17 <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-serbia-justice-agreement-expected-to-be-implemented-10-16-2017>

#### **Rastet:**

*Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër Gjykatës Supreme të Kosovës*, KI 40/09, 2009, Gjykata Kushtetuese e Kosovës;

*Kastrati kundër Gjykatës Supreme*, KI 68/09, 2009, Gjykata Kushtetuese e Kosovës;

*Bislimi kundër MI dhe të tjerëve*, KI 06/10, 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës.







